



Проект за зајакнување на иновативен туризам
 Проект për avancimin e turizmit bashkëkohor
 Smart Tourism Enhancement Project



THE EUROPEAN UNION'S CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME

Për nevojat e projektit "Ndërmarrja Sociale - Projekti për avancimin e turizmit bashkëkohor (STEP)" i financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit për bashkëpunim ndërkuftar (IPA II 2014-2015), në bazë të marrëveshjes për grant me numrin referent IPA/2017/390-054, komisioni i prokurimeve pranë Fondacionit për internetit dhe shoqërisë "Metamorfozis" Shkup, në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillimin e Rajonit Planifikues të Pollogut - Tetovë dhe Këshillin e Qarkut Elbasan, shpall:

THIRRJE PËR DORËZIMIN E OFERTAVE nr. 05-2019

Për prokurimin/furnizimin e shërbimeve për zhvillimin e zgjidhjes softuerike për një platformë ndër-rajonale onlajn të turizmit

1. Organi kontraktues

Fondacioni për internet dhe shoqëri - Metamorfozis, Shkup, me seli në rr. Apostoll Gusllarot Nr. 40, 1000 Shkup, në kuadër të projektit "Ndërmarrja Sociale - Projekti për avancimin e turizmit bashkëkohor (STEP)"

2. Sfondi i projektit

Projekti është një kontratë për grant i IPA 2, Program i Bashkimit Evropian për bashkëpunim ndërkuftar: alokimet 2014-2015. Partnerë të projektit janë Fondacioni Metamorfozis për internet dhe shoqëri, Qendra për zhvillimin e rajonit planifikues të Pollogut dhe Këshilli i Qarkut Elbasan. Kohëzgjatja: 27 muaj.

Qëllimet:

- Promovimi i një sektori turistik aktiv që përshtatet në mënyrë efektive ndaj nevojave të tregjeve vendore dhe ndërkombëtare
- Rritja e kapaciteteve të bizneseve turistike dhe ndërtimi i partneriteteve strategjike dhe bashkëpunimit në vend, rajon dhe më gjerë
- Zgjerimi dhe avancimi i qasjes strategjike dhe të koordinuar në tregjet turistike të reja specifike duke përdorur teknologji të reja
- Përshpejtimi i rritjes dhe stimulimi i krijimit të vendeve të reja të punës

Elementet kryesore:

- Ngritja e ndërgjegjësimit dhe kuptimit të nevojës për qasje të re të marketingut në turizëm
- Shkëmbimi i informacionit, bashkëpunimi dhe zhvillimi i përbashkët i produkteve brenda zonës ndërkuftare
- Ekspertiza lokale midis subjekteve private dhe publike për të zhvilluar politikat dhe standardet e nevojshme që plotësojnë standardet ndërkombëtare për zhvillimin e turizmit
- Ndërtimi i strategjisë nëpërmjet konsultimit dhe koordinimit të gjerë
- Rrjetëzimi dhe ndërkombëtarizimi i zinxhirëve të vlerave
- Ndërtimi i lidhjeve ndërmjet turizmit dhe kulturës



The Smart Tourism Enhancement Project is implemented by Metamorphosis Foundation in cooperation with the Centre for Development of Polog Planning Region and the Council of the Elbasan County



- Trajnimi dhe mentorim për të forcuar kapacitetin e NVM-ve për përdorim efikas të teknologjisë
- Mbështetja e projekteve konkrete cilësore për t'u përdorur si shembuj më të mirë për motivimin dhe nxitjen e turizmit ndërkufitar

Rezultatet e pritura:

- Rritja e kërkesës për turizëm në rajon nëpërmjet rritjes së përmbajtjes dhe aktivitetit në internet
- Rritja e kapacitetit të biznesit të turizmit për përdorimin strategjik të teknologjisë informative
- Krijimi i rrjetit STEP të entiteteve publike dhe private të informuara dhe të fuqizuara, OSHC-të, grupet e turizmit dhe/ose dhomat e tregtisë;
- Krijimi i një marke të besueshme STEP që krijon besim, cilësi dhe integritet për NVM në rajonin ndërkufitar
- Rritja e kapacitetit të bizneseve turistike dhe sipërmarrësve individualë për ndërkombëtarizim, lidhje dhe partneritet
- Krijimi i Platformës Ndër-Rajonale të Turizmit Online (iTOP)

3. Lënda e kontratës për prokurimin e shërbimit

Lëndë e kontratës për prokurim është zhvillimi i zgjidhjes softuerike për platformë ndër-rajonale të turizmit onlajn "I-Top"

Platforma onlajn I-TOP do të shërbejë si një platformë trepalëshe B2B dhe/ose B2C midis palëve të ndryshme të interesuara, e cila do të përfshijë ndërmjetësimin e njeriut, gjatë krijimit të "paketeve turistike" individuale për shijet e ndryshme turistike. Në një skenar për ilustrim, sipërmarrësit do t'i ofrojnë shërbimet e tyre në platformë, "ndërmjetësi lokal njerëzor", i cili është i njohur së afërmi me ofertën, do të krijojë paketa tematike dhe më në fund turisti do të përcaktohet për njërin prej tyre. Gjithashtu, sipërmarrësit do të jenë në gjendje vetë t'i krijojnë paketat dhe kështu t'i ofrojnë ato pa "ndërmjetësim" nga pala e tretë. Ngjashëm me këtë, në platformën B2B, agjencitë turistike mund të krijojnë ose të blejnë paketa turistike dhe t'i ofrojnë ato nëpërmjet kanaleve të ndryshme të komunikimit. Në të njëjtën kohë, platforma mund të shërbejë si një platformë B2C dhe t'u ofrojë shërbim të drejtpërdrejtë klientëve pa asnjë ndërhyrje.

Platforma, po ashtu do të përfshijë edhe ueb-shërbime, që do t'i sjellin ofertat ekzistuese turistike në rajonet e synuara, nga ueb-faqet e njohura (tripadvisor.com, booking.com), rejtingjet e tyre, komentet dhe të dhënat e tjera meta dhe do t'ua paraqesin ato përdoruesve në mënyrë të lehtë për përdorim në iTOP. Përfitimet nga kjo qasje janë dy shtresore: së pari, kjo do t'i mundësojë platformës të jetë e pasur me përmbajtje që nga fillimi, pasi do të ushqejë përmbajtjen automatikisht nga ueb-shërbimet ekzistuese si tripadvisor.com dhe booking.com, ndërsa e dyta, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, hotelet, restorantet, etj., nuk duhet ta dërgojnë ofertën e tyre më shumë se një herë në sistemin e tyre të preferuar (rezervimi, Airbnb, etj.). Përveç kësaj, ekipi i projektit për TIK i rrjetit STEP ka pasqyrë të ofertës së plotë nga rajonet në të dy anët e kufirit,





duke ofruar ndihmë sipas nevojës. Ajo që është më e rëndësishme, iTOP lejon në mënyrë shumë novatore ndërmjetësimin e njeriut (për shembull, guidët turistike, entuziastët etj.), si dhe mundësi për t'i kombinuar ofertat, madje edhe gjëra të caktuara nga oferta të ndryshme, në ofertat e vetme të sapo-përcaktuara -

- ofron përvoja unike turistike. Sistemi gjithashtu duhet të ofrojë mundësi për turistët që t'i personalizojnë "kërkesat" e tyre, të kombinuara me ofertat e platformës, të cilat pastaj përkojnë me "ndërmjetësuesit njerëzorë" të përshtatshëm për kërkesat. Në kontekst, sfida e tërheqjes së vizitorëve për shfrytëzimin e iTOP-it do të zgjidhet jo vetëm përmes reklamimit të saj, por edhe duke i promovuar funksionet e saj novatore dhe tërheqëse në rrjetet sociale (FB, YouTube, etj.). iTOP do të përdoret për të promovuar dhe për të ofruar qasje të mëtejshme në tregje për iniciativat e mbështetura ndërkufitare përmes skemës për mbështetje me grante të vogla të STEP-it. Gjithashtu, do të ofrojë eksperiencë reale dhe testim të njohurive të fituara përmes veprimeve të Aksionit.

Një përshkrim më i hollësishëm i shërbimeve të kërkuara gjendet në specifikimin në këtë dokumentacion. Vlera e paraparë e prokurimit është 11.200,00 euro (EUR) në kundërvlerë në denarë.

Prokurimi do të realizohet nga një furnizues me përvojë në ofrimin e këtij lloji të shërbimeve. Fondacioni për internet dhe shoqëri - Metamorphosis, Shkup, në përputhje me dispozitat e kontratës me donatorin dhe rregullorjen e brendshme për realizimin e prokurimit zbaton thirrje të kufizuar duke mbledhur të paktën 3 oferta.

4. Kurshtet dhe kriteret për pjesëmarrje në thirrje

Për të marrë pjesë në procedurën e dhënies së kontratës, ofertuesit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për përcaktimin e aftësisë së tyre:

4.1. Gjendja personale e ofertuesit

- në 5 vitet e fundit, ofertuesit të mos i jetë shqiptuar ndonjë aktgjykim i plotfuqishëm për pjesëmarrje në organizatë kriminale, korrupsion, mashtrim apo larje parash;
- ofertuesit të mos i jetë shqiptuar dënim dytësor i përkohshëm ose i përhershëm në ushtrimin e veprimtarisë së caktuar;
- ofertuesi të mos jetë në procedurë falimentimi ose likuidimi;
- ofertuesi të mos ketë tatime, kontribute apo të dhëna të tjera publike të papaguara;
- ofertuesit të mos i jetë shqiptuar një sanksion për kundërvajtje - ndalesë për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, gjegjësisht ndalesë e përkohshme për kryerjen e veprimtarisë së caktuar.



Ofertuesi e konfirmon përmbushjen e kriterëve për përcaktimin e statusit personal me deklaratë të cilët ia bashkangjet ofertës së tij (deklarata është dhënë si shtojcë e këtij dokumentacioni të tenderit - shtojca 3).

Përveç deklaratës, ofertuesi së bashku me ofertën nuk duhet të dorëzojë dokumente për vërtetimin e gjendjes personale. Për qëllime të verifikimit, Komisioni mund të kërkojë nga ofertuesi, ofertën e të cilit e ka konstatuar se më të volitshme që t'i dorëzojë dokumentet e nevojshme për përcaktimin e gjendjes së tij personale për verifikimin e këtyre kriterëve.

4.2. Gjendja ekonomike dhe financiare

Për t'u kualifikuar si i aftë për ta realizuar këtë kontratë të prokurimit publik në kuptim të gjendjes së tij ekonomike dhe financiare, ofertuesi duhet ta përmbushë kushtin e mëposhtëm minimal:

- të ketë realizuar të ardhura jo më pak se vlera e paraparë e prokurimit në të paktën njërin nga tre vitet e fundit.

Nëse operatori ekonomik e ushtron veprimtarinë në periudhë më të shkurtër se tre vjet, kushti minimal për përcaktimin e gjendjes ekonomike dhe financiare është që ofertuesi ta ketë përmbushur kushtin e paragrafit 1 në vitet për të cilat ka të dhëna.

Ofertuesi e dëshmon përmbushjen e kushtit minimal duke dorëzuar:

- Bilanc të suksesit të vërtetuar dhe të lëshuar nga organi kompetent

4.3 Aftësia teknike ose profesionale

Kriteret për përcaktimin e aftësisë teknike ose profesionale të ofertuesit janë:

Për t'u kualifikuar si i aftë për ta realizuar këtë kontratë të prokurimit publik në kuptim të gjendjes së tij ekonomike dhe financiare, ofertuesi duhet t'i përmbushë kushtet e mëposhtme minimal:

- Ofertuesi të ketë realizuar me sukses të paktën 3 (tre) kontrata që lidhen me lëndën e prokurimit në 3 (tre) vitet e fundit

Operatori ekonomik e dëshmon përmbushjen e kushteve minimale duke dorëzuar:





- Listë të referencave për kontrata të realizuara me sukses në lidhje me lëndën e prokurimit në tre vitet e fundit, me vlerat e kontratave, datat e lidhjes së kontratave, blerësit (organet kontraktuese)
- **shtojca 2**

5. Oferta duhet t'i përmbajë elementet e mëposhtme:

- Oferta (Formulari në shtojcën 1 në dokumentacionin e tenderit)
- Deklaratë me të cilën ofertuesi konfirmon se i plotëson kriteret për përcaktimin e gjendjes personale (Formulari në shtojcën 2 në dokumentacionin e tenderit)
- Deklaratë me të cilën ofertuesi i pranon kushtet nga dokumentacioni i tenderit (Shtojca 3)
- Deklaratë për bilancin e suksesit të vërtetuar nga organi kompetent
- Lista e referencave (formulari në shtojcën 4 të dokumentacionit të tenderit)
- Dokumentacioni teknik:
 - o Përshkrimi i zgjidhjes së ofruar teknike
- Dokumentacioni financiar:
 - o Oferta financiare - në zarf të veçantë (formulari në shtojcën 5 në dokumentacionin e tenderit)

6. Afati i fundit për realizimin e shërbimit

Zgjidhja e softuerit duhet të zhvillohet dhe të vihet në funksion, më së shumti në afat prej 3 (tre) muajsh nga data e lidhjes së Kontratës.

7. Ndarja e prokurimit

Prokurimi është i pandashëm. Ofertuesi duhet të dorëzojë ofertë për gjithë lëndën e prokurimit, d.t.th. për të gjitha 10 modulet nga Shtojca 6, iTOP ToR v1.

8. Periudha e vlefshmërisë së ofertës

Periudha e vlefshmërisë së ofertës duhet të jetë së paku 30 ditë nga dita e fatit të fundit për dorëzimin e ofertave, për të cilën kohëzgjatje oferta është e detyrueshme për ofertuesin në të gjitha elementet e tij .

9. Sqarim i dokumentacionit të tenderit

Të gjitha kërkesat për sqarim të dokumentacionit të tenderit mund të dërgohen në e-mail-in: florent@metamorphosis.org.mk, jo më vonë se 09.04.2019.





Проект за зајакнување на иновативен туризам
Projekt për avancimin e turizmit bashkëkohor
Smart Tourism Enhancement Project



THE EUROPEAN UNION'S CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME

Sqarimet e kërkuara në lidhje me dokumentacionin e tenderit do të publikohen jo më vonë se 3 ditë para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave, në ueb-faqen e projektit STEP www.step.mk

10. Ndryshimi dhe plotësimi i dokumentacionit të tenderit

Fondacioni Metamorfozis e rezervon të drejtën jo më vonë se 5 ditë para skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave, sipas gjykimit të vet ose në bazë të pyetjeve të parashtruara për sqarime, të parashtruara nga ofertuesit, ta ndryshojë ose ta plotësojë dokumentacionin e tenderit, dhe atë do ta publikojë menjëherë në ueb-faqen e projektit STEP (www.step.mk), dhe do t'i njoftojë ofertuesit e mundshëm që kanë parashtruar kërkesë për sqarim.

Në rasti të ndryshimit të dokumentacionit të tenderit, Fondacioni Metamorfozis mund ta zgjasë afatin e fundit për dorëzimin e ofertës sipas kërkesës, nëse ka shkaqe të arsyeshme për këtë, dhe atë do ta publikojë në ueb-faqen e projektit STEP (www.step.mk)

11. Mënyra e dorëzimit të ofertave

Ofertat duhet të dorëzohen në formë letre me anë të shërbimit postar ose personalisht. Në ofertë, oferta financiare të vendoset në një zarf të veçantë dhe të shënohet.

Oferta dorëzohet në një zarf të mbyllur me shënimin "PËR PROJEKTIN STEP" (i cili do ta përmbajë ofertën e veçuar financiare) në të cilin në këndin e poshtëm të majtë duhet të shënohet "MOS E HAP" dhe numri i thirrjes 05/2019 të cilit i referohet oferta.

Ofertat dorëzohen në zyrat e Fondacionit Metamorfozis në rr. Apostoll Gusllarot 40, Shkup.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është të hënën, **15.04.2019, deri në orën 12:00.**

Ofertat që do të mbërrijnë pas këtij afati, si dhe ato oferta që nuk do t'i përmbajnë elementet e nevojshme ose që nuk janë përgatitur sipas kushteve të thirrjes, nuk do të merren parasysh për vlerësim të mëtejshëm. Secili ofertues mund të marrë pjesë me vetëm një ofertë.

12. Kushtet dhe mënyra e pagesës

Pagesa: 40% pas nënshkrimit të Kontratës, dhe 60% pas dorëzimit dhe miratimit të zgjidhjes softuerike nga ekipi i projektit.

13. Kriteret për dhënien e kontratës

Zgjedhja e furnizuesve do të bëhet duke e vlerësuar ofertën cilësore dhe financiare (80 pikë për ofertën cilësore dhe 20 pikë për ofertën financiare). Në procesin e vlerësimit do të zbatohet një procedurë me dy faza, gjegjësisht fillimisht bëhet vlerësimi i cilësisë e pastaj edhe i çmimit. Ofertat financiare hapen dhe



The Smart Tourism Enhancement Project is implemented by Metamorphosis Foundation in cooperation with the Centre for Development of Polog Planning Region and the Council of the Elbasan County



vlerësohen vetëm nëse ofertuesit fitojnë minimum 51 pikët nga 80 pikët e parapara (maksimale) për cilësi.

Elementi	Pikët maksimale
1. Cilësia	80
- Cilësia e zgjidhjes së ofruar teknike	50
- referencat për zgjidhjet e mëparshme softuerike	10
- përvoja në zbatimin e platformave onlajn, të ngjashme ose të njëjta me lëndën e prokurimit	10
- Afati i fundit i dorëzimit	10
2. Çmimi	20
Gjithsej (1+2)	100

Për kriterin e cilësisë, do të vlerësohen aspektet e mëposhtme:

- cilësia e zgjidhjes së ofruar teknike
- referencat për zgjidhjet e mëparshme softuerike
- përvoja në zbatimin e platformave onlajn, të ngjashme ose të njëjta me lëndën e prokurimit
- Afati i fundit i dorëzimit

Do të përzgjidhet ofruesi i cili do të marrë gjithsej numrin më të madh të pikëve (cilësia + çmimi).

14. Njoftimi i ofertuesve

Pas përfundimit të vlerësimit të ofertave të dorëzuara, Komisioni do t'u dorëzojë të gjithë pjesëmarrësve në tender njoftim me informacion për ofertuesin më të favorshëm të përzgjedhur, si dhe arsyet për moszgjedhjen e ofertës së tyre për ofertuesit që nuk janë zgjedhur. Njoftimi do të dërgohet në adresën e e-mail-it të shënuar në ofertë.

Shkup, 13 mars 2019

**Komisioni për Prokurime Publike
Fondacioni për internet dhe shoqëri Metamorfozis Shkup**

